



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 115 datë 17.12 2025

PËR

**MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027 TË
BASHKISË PËRMET**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin e përgatitjes së programit afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027 të Bashkisë Përmet, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI



Lidhja nr.1

**KALENDARIT TE PERGATITJES SE PROGARMIT BUXHETOR AFATMESE 2027-2029
DHE BUXHETIT VJETOR 2027 .**



Kalendari PBA
BUXHETIT VJETOR

- Pergatitet nga kryetari njesise se vetqeverisjes vendore dhe i propozohet me tej Keshillit te njesise .
- Miratohet nga keshilli i njesise brenda dates 02.02.2026.
- Hyn ne fuqi dhe shperndahet tek te gjitha njesite shpenzuese nga Kryetari i njesise (16.02.2026)

Vlersimet dhe
parashikimet e te
ardhurave dhe
shpenzimeve

- Kryetari paraqet per shqyrtim dhe miratim ne keshill brenda dates 27.02.2026
- Keshilli miraton raportin e vlersimit (02.03.2026)

Tavanet e shpenzimeve
PBA ne nivel programi

- Kryetari i njesise propozon tavanet pergatitore per miratimin ne keshill (02.03.2026),
- Keshilli miraton tavanet pergatitore(16.03.2026).
- Kryetari i njesise udhezimin per pergatitjen e buxhetit (5 dite nga miratimi i taveve)
- Udhezimi shperndahet tek njesite shpenzuese (5 dite miratimi i taveve 21.03.2026).
- Tavanet perfundimtare paraqiten nga Kryetari i njesise ne Keshill(korrik viti 2026).
- Keshilli miraton tavanet perfundimtare (20.07.2026)
- Kryetari i njesise nxjerr udhezimin plotesues per pergatitjen e buxhetit te njesise dhe shperndan tek te gjitha njesite shpenzuese (5 dite nga miratimi i taveve perfundimtare 27.07.2026)

Kerkesat sipas
taveve

- Njesite shpenzuese paraqesin kerkesat brenda taveve pergatitore tek Njesia e Menaxhimit te Programeve (Prill,2026) dhe japin argumenta per fonde /tave shtese
- Njesite shpenzuese paraqesin kerkesat brenda taveve perfundimtare (03.08.2026)



PBA BUXHETIT
VJETOR

- Kryetari i njesise pergatit dokumentin e I-re te PBA, viti 2027-2029 (31.05.2026)
- Kryetari njesise dergon MFE PBA (01.06.2026)
- MFE dergon opinionin e saj mbi PBA tek njesia Vendore (22.06.2026)
- Kryetari i njesise vendore dergon PBA se bashku me opinionin e MFE per miratim ne Keshill (23.06.2026).
- Keshilli i njesise vendore miraton dokumentin e pare te PBA (30.06.2026)
- Kryetari publikon PBA / dokumentin e pare (06.07.2026).
- MFE nxjerr udhezimin plotesues per rishikimin e PBA (09.07.2026).
- Njesia rishikon PBA (Korrik, Gusht 2026).
- Njesia organizon takime konsultuese (1-15.09.2026)
- Njesia dergon PBA e rishikuar ne MFE (15.09.2026)
- MFE zhvillon seanca konsultimi me njesite e vete qeverisjes vendore (05.10.2026).
- MFE dergon opinionin perfundimtar sipas rastit tek njesia vendore (20.10.2026)
- Kryetari i Bashkise paraqet per miratim ne Keshill PBA dhe buxhetin vjetor perfundimtar (30.11.2026)
- Keshilli miraton PBA dhe Buxhetin vjetor (25.12.2026)
- Kryetari i njesise publikon PBA dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqeruese (31.12.2026)

